VENDIM
Nr. 808, datë 16.11.2016

PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË KONCESIONIT PËR RAFINERI SHOQËRISË AKSIONARE "RBH BELINE"

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 19, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e licencës së koncesionit për rafineri shoqërisë aksionare "RBH Beline", me NIPT L22524401A dhe seli në Balldren, Elbasan, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LICENCË KONCESIONI
PËR RAFINERI

Nr. 4773/7, datë 8.11.2016

Në mbështetje të nenit 12, pika 2, dhe nenit 18, pika 3, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 19, datë 14.1.2015, të Këshillit Ministrave, "Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj", shoqëria aksionare "RBH Beline" është pajisur me miratim paraprak nr. 4812/2, datë 15.9.2014, nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

I jepet shoqërisë aksionare "RBH Beline", me NIPT L22524401A dhe seli në Balldren, Elbasan, Licenca e Koncesionit për Rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto dhe për prodhimin e nënprodukteve të saj.

a) Emri dhe selia e personit juridik:

Shoqëria aksionare "RBH Beline", me seli në Balldren, Elbasan. Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, datë 24.1.2012, me NIPT: L22524401A.

b) Koordinatat dhe vendndodhja e rafinerisë;

Nr.	Koordinatat gjeodezike	
	X	Y
1	X=4416533.50	Y=4550728.315
2	X=4416457.256	Y=4550766.496
3	X=4416663.558	Y=4550669.893
4	X=4416621.833	Y=455.631.713

c) Numri dhe data e vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e lejes së ndërtimit/zhvillimit:

- "Leje zhvillimore komplekse" me vendim nr. 2, datë 29.12.2014, objekti: "Rafineri për prodhim bitumi dhe nënprodukte të naftës", nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

ç) Lloji i licencës së tregtimit dhe afati i saj, nëse personi juridik është pajisur me këtë licencë;

Licencë tregtimi me shumicë nr. LN- 6195-02-213, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.

Prodhim, depozitim, transport, përdorim dhe/ose tregtim i produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera të rrezikshme.

Afati i vlefshmërisë së kësaj licence është pa afat.

d) Afati i vlefshmërisë së licencës së koncesionit;

30 vjet me të drejtë përsëritjeje, pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave.

E drejta për rinovimin e kësaj licence bëhet sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në kreun V, të VKM-së nr. 19, datë 14.1.2015, "Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj".

dh) Afati i përfundimit të ndërtimit të rafinerisë, afati i vënies në përdorim, si dhe rastet kur do të lejohet shtyrja e afatit të ndërtimit apo vënies në përdorim.

Objekti ka përfunduar ndërtimin në bazë të lejes së ndërtimit dhe është pajisur me leje përdorimi nr. 1116/4 prot., datë 5.8.2016, nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit. Afati i vënies në përdorim është 31.12.2016.

e) E drejta e organeve dhe institucioneve shtetërore, të ngarkuara me ligj, për kontrollin e zbatimit të projektit sipas kushteve dhe afatit të përcaktuar në projekt.

ë) Këshilli i Ministrave ka të drejtë revokimin e kësaj licence kur nga kontrollet e ushtruara nga organet dhe institucionet shtetërore, të ngarkuara me ligj, konstatohet dështimi i përmbushjes së kërkesave të licencës së koncesionit për rafineri, në zbatimin e parametrave teknikë, në afatin e realizimit të projektit dhe të normave mjedisore;

f) Kapaciteti dhe kategoria e produkteve që do të prodhojë rafineria.

Kapaciteti i përpunimit të naftës bruto është 600 tonë/24 orë.

Produktet që do të prodhojë rafineria janë të përshkruara në kartën teknologjike të lëshuar nga ISHTI-ja, bashkëlidhur licencës, e cila është pjesë e integruar e saj.

g) Shoqëria aksionare "RBH Beline", pas miratimit të kësaj licence koncesioni duhet të paguajë tarifën e licencimit sipas legjislacionit në fuqi. Licenca e koncesionit është e vlefshme vetëm pas pagesës së tarifës së licencimit.

gj) Shoqëria aksionare "RBH Beline" pas miratimit të kësaj licence koncesioni, në zbatim të kërkesave të nenit 9, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, ka detyrim mbajtjen e rezervës së sigurisë, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara këtu.

h) Shoqëria aksionare "RBH Beline" pas miratimit të kësaj licence koncesioni duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, informacionet dhe të dhënat përkatëse, brenda afateve, në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.

i) Shoqëria aksionare "RBH Beline" në rastin e ndryshimeve në skemën dhe kartën teknologjike të funksionimit të rafinerisë, si dhe për markën e cilësinë e nënprodukteve të naftës të prodhuara nga rafineria, duhet të zbatojë përcaktimet e nenit 12, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.

Kjo licencë koncesioni për rafineri do të udhëhiqet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim, pretendim ose ndryshim opinioni, që lind nga/ose në lidhje me këtë licencë koncesioni, do të trajtohet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRISË
Damian Gjiknuri